

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-3/09

19 Maj 2011

Në procedurën e

Z.J.

Paraqitësi i kërkesës/ankuesi

vs.

R.H.

Pala përgjegjëse/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP-ës) i përbërë nga gjyqtarët: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryesuese, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë- Anëtarë të Kolegjit, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/34/2008, (dosja e lëndës është regjistruar në AKP me numrin KPA 10480), të datës 19 dhjetor 2008, pas seancës gjyqësore me 19 Maj 2011, morri këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z.J., e paraqitur kundër vendimit të KPCC/D/R/34/2008, të datës 19 dhjetor 2008.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC/D/R/34/2008, i datës 19 Dhjetor 2008.

3. **Obligohet paditësi që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 50 (pesëdhjetë) € nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.**

Zhvillimet procedurale dhe faktike:

Me 13 Dhjetor 2007 Z.J. ka paraqitur kërkesë para Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP-ës) ku ceket si në vijim:

Me vendimin nr. 4466, me numër rëndor 6-14, i datës 12 Qershor 1999, të Komandës Ushtarake të Armatës Jugosllave, atij, si punëtor civil i Armatës Jugosllave, i është dhënë një banesë në Ferizaj/Uroševac, në rrugën Boshko Çakiç, nr. 48, kati I/8. Pastaj, me kontratën nr. 5374, me numër rëndor 400-2, të datës 18 Qershor 1999, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Nish në të njëjtën ditë me numër II.OV-br.1280/99, kjo banesë (numër 8 në rrugën Boshko Çakiç nr. 48, me sipërfaqe prej 34.37 metra katror), e cila ka qenë në pronësi të Komandës Ushtarake të RFJ-së në Nish, i është shitur atij. Me vendimin nr. 5374, me numër rëndor 400-3, të Komandës Ushtarake në Nish, të datës 18 Qershor 1999, atij i është lejuar që të regjistrojë banesën e lartpërmendur në librat publik për pronë të paluajtshme, sepse ai kishte paguar çmimin e plotë për këtë banesë.

Padia e Z.J. ishte regjistruar si kërkesa KPA10480.

Pala përgjegjëse, R.H., ka deklaruar se ka shfrytëzuar banesën e kontestuar në bazë të vendimeve të nxjerra nga organet kompetente. Me vendimin e Brigadës KPC 30 të Xhenios nga Ferizaj nr. 25/32, të datës 16 Shkurt 2001, atij i është ndarë banesa një dhomëshe në Ferizaj në rrugën Ramadan Rexhepi, blloku I, hyrja e parë, kati i dytë, banesa 8. Për më tepër, pala përgjegjëse ka cekur se në bazë të vendimit grupor HPCC/D/189/2005, të datës 30 Prill 2005, kërkesa e Z.J. DS 200304 tashmë është hedhur poshtë. Prandaj, pala përgjegjëse ka deklaruar se kërkesa për ri-posedim ka qenë e pabazuar.

Me vendimin e HPCC/D/189/2005/C, të datës 30 prill 2005, kërkesa e Z.J. për ri-posedim të banesës në fjalë është hedhur poshtë mbi bazën se ai nuk kishte arritur të konfirmojë se kishte pasur të drejtat pronësore deri me 24 Mars 1999.

Me vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/34/2008, të datës 19 Dhjetor 2008, është refuzuar kërkesa e paraqitësit të kërkesës Z.J. ku kërkohet njohja e të drejtave

pronësore për banesën që ndodhet në Ferizaj, në rrugën Boshko Çakiç, nr. 48, hyrja 8, numër 8, me sipërfaqe prej 34.37 m². Komisioni ka qenë i mendimit se kontrata e shitblerjes lidhur me këtë banesë e nënshkruar ndërmjet Svetomir Kovačević në emër të shtetit të RFJ-Qeverisë Federative – Ministria Federative e Mbrojtës, Komanda nr.. 5374 – si shitës dhe paraqitësit të kërkesës si blerës, ka qenë e pavlefshme sepse ka qenë në kundërshtim me neni 6 të Rregullorës së UNMIK-ut 1999/1. Sipas kësaj dispozite ligjore theksohet se UNMIK-u administron pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruar në emër të Republikës Federative të Jugosllavisë apo të Republikës së Serbisë dhe të objekteve të tyre. Rrjedhimisht, aktvendimi për ndarjen e banesës si dhe kontrata e shitblerjes e datës 18 Qershor 1999 janë nënshkruar nga organet të cilat nuk kanë pasur autorizime apo juridiksion për ta bërë këtë, këto dokumente kanë qenë të pavlefshme dhe pa efekt ligjor.

Paraqitësi i kërkesës ka bërë ankesë kundër këtij vendimi të Komisionit brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Ai ka theksuar se vërtetimi i gjendjes faktike ka qenë i gabuar dhe jo i plotë dhe se e drejta materiale është zbatuar gabimisht. Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Supreme që, në pajtim me dispozitën e nenit 13.3, nënparagrafin (a) të Rregullores së UNMIK 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, të pranojë kërkesën e tij dhe të nxjerrë një vendim të ri me ndryshimet e nevojshme me qëllim të njohjes së të drejtës së tij pronësore dhe t'i jepet atij posedimi..

Ndonëse palës përgjegjëse në ankesë i është dorëzuar ankesa, ai nuk ka dhënë përgjigje.

Arsyetim ligjor:

Kolegji i Paleit të Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar vendimin e kundërshtuar në pajtim me nenin 13.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Pas rishikimit të shkresave të lëndës lidhur me konkluzionet e lartpërmendura faktike, gjykata vlerëson të drejtë vendimin e kundërshtuar të KKKP-së dhe si të pabazë ankesën e paraqitësit të kërkesës për konfirmim e të drejtës së pronësisë. Kontrata e shitblerjes e lidhur me ankuesin me datë 18 Qershor 1999, lidhur me banesën që ndodhet në Ferizaj, në rrugën Boshko Çakiç, nr. 48, hyrja 8, numër 1, është lidhur në kundërshtim me nenin 6 të Rregullorës së lartpërmendur, kështu që e njëjta ligjërisht është e pavlefshme dhe nuk ka efekt ligjor.

Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar vendimin e kundërshtuar në bazë të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) 03/L-006 (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 38, 20 shtator 2008), i cili, sipas nenit

të tij 538 ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare, që do të thotë para nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me 19 dhjetor 2008. Si rrjedhojë, ai është i zbatueshëm në rastin konkret.

Në pajtim me nenin 194 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë duhet të shqyrtojë sipas detyrës zyrtare nëse ekziston ndonjë shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore të nenit të tij 182.2.

Në pajtim me nenin 182.2 i) të LPK-së, gjithmonë ekziston shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore nëse vendimi merret për një lëndë e cila tashmë është gjykuar me një aktgjykim të plotfuqishëm.

Ndonëse kërkesa e Z.J. lidhur me ri-posedim të banesës në rrugën “Boshko Çakiq” 48/1/8, banesa nr. 8 në Ferizaj, është refuzuar nga vendimi HPCC/D/189/2005/C, i datës 30 prill 2005, ajo nuk paraqet ndonjë situatë res judicata. Është e vërtetë se palët dhe qëllimi i kërkesave të tyre para KKPB-së dhe KKPK-së janë të njëjta. Por me qëllim të parashtrimit në mënyrë të ligjshme të një kërkesë në procedurë të shkallës së parë, neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe neni 1.2 (c) i Rregullorës së UNMIK-ut 1999/23, e cila i referohet nenit 7.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/60 parashih se paraqitësi i kërkesës duhet të jetë posedues i pronës së paluajtshme - banesës para 24 marsit 1999. Për arsye se paraqitësi i kërkesës nuk ka qenë në posedim të banesës para 24 Marsit 1999 siç tregohet nga vetë ai, KKPB-ja e kishte kundërshtuar kërkesën e tij.

Neni 3.1 i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 përcakton kërkesat që AKP-ja duhet t'i pranojë si kërkesa lidhur me të drejtën e pronësisë dhe kërkesa që përfshijnë të drejtat për shfrytëzim të pronës në lidhje me pronën e paluajtshme private ku paraqitësi i kërkesës nuk është tani në gjendje t'i ushtrojë të drejtat e tilla pronësore. Në këtë mënyrë, aty nuk ceket ndonjë kërkesë për posedim të mëhershëm fizik të pronës së paluajtshme ashtu siç ceket qartë në Rregulloren 2000/60. Prandaj, është e vërtetë se gjendja faktike që më pas i është paraqitur Komisionit nga paraqitësi i kërkesës ishte e njëjtë. Sidoqoftë, baza ligjore mbi të cilën ai kishte mbështetur kërkesën e tij ia lejon atij të drejtën e shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë, përderisa ai nuk ka plotësuar kriteret ligjore në procedurën e shkallës së parë.

Rrjedhimisht, Kolegji i Apelit të AKP-ës, i Gjykatës Supreme konsideron se nuk ekziston ndonjë shkelje e dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që do të pengonte të njëjtën lëndë të gjykohej dy herë.

Kërkesa e paraqitësit të kërkesës është e pabazuar. Në bazë të fakteve të konfirmuara dhe provave të administruara, nuk ka dyshim se gjendja faktike në këtë çështje ligjore është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

AKP-ja ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, më saktësisht Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë. Në përputhje me nenin 6 të kësaj Rregulloreje, parashihet se *“UNMIK-u administron pasurinë e luajtshme ose të paluajtshme, duke përfshirë financat, llogaritë bankare dhe format e tjera të pronës të regjistruara në emër të Republikës Federative të Jugosllavisë, të Republikës së Serbisë apo të cilitdo organ të saj, të cilat gjendet në territorin e Kosovës”*. Neni 7 parasheh që kjo rregullore të hyjë në fuqi me 10 Qershor 1999.

Aktvendimi i Komandës Ushtarake në Ferizaj nr. 4466 i 12 Qershorit 1999, nëpërmjet të cilit paraqitësit të kërkesës i është dhënë me qira banesa, si dhe kontrata e Komandës Ushtarake në Nish e datës 18 Qershor 1999, në cilësi të qiradhënësit apo shitësit të banesës, është bërë nga RFJ-ja apo strukturat e saj ushtarake në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1. Neni 6 i kësaj Rregulloreje shprehimisht parasheh se pas datës 10 Qershor 1999, prona e luajtshme dhe e paluajtshme e regjistruar në emër të RFJ-së dhe RS-së do të administrohet nga UNMIK-ut. Prandaj, të dy aktvendimet e lëshuara pas datës 10 qershor 1999 janë nxjerrë nga një organizatë e cila nuk ka pasur autorizime për të ndërmarrë veprime të vlefshme ligjore me qëllim të dhënies me qira apo lidhjes së kontratës së shitblerjes. Rrjedhimisht, këto kontrata apo aktvendime janë ligjërisht të pavlefshme dhe pa efekt ligjor. Duke pasur parasysh faktin se si aktvendimi ashtu edhe kontrata janë të paligjshme, ato nuk rezultojnë në detyrime ligjore apo obligime materiale nga momenti që janë marrë-lidhë, që do të thotë se kontrata dhe aktvendimi janë ex tunc të pavlefshme. Neni 103 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore parasheh se në rast se kontratat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, ato janë të pavlefshme që nga momenti i krijimit të tyre, në këtë rast, kontrata nuk ka efekt ligjor që nga 18 Qershori i vitit 1999.

Shpenzimet e procedurës

Në përputhje me Shtojcën III, neni 8.4 i Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive të Komisionit.

Megjithatë, një lirim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të ankesave.

Si pasojë, regjimi normal i taksave gjyqësore siç parashihet me Ligjin për Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK – 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore zbatohet për procedurën para Kolegjit të ankesave.

Në këtë mënyrë, gjykata vendosi t'i caktojë taksat e mëposhtme gjyqësore në këtë procedurë ankimore:

- shuma e taksës gjyqësore për paraqitje të kërkesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- shuma e taksës gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (neni 10.21 dhe 10.1 i UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme si vlerë në shumën prej € 5001 dhe 10000: € 50 (pesëdhjet).

Taksat gjyqësore do të paguhet nga ankuesi i cili humb rastin siç parashihet me nenin 452.1 në lidhje me nenin 473.1 të LPK-së. Afati për pagesë parashihet në nenin 45, paragrafin 1 të Ligjit për Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK – 3 tetor 1987)

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykimi është i formës së prerë dhe i detyrueshëm dhe se nuk mund të kundërshtohet me anë të mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, EULEX Registrar